



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-19581

Dt. 06.03.2026

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e **Spitali Rajonal PRIM.Daut Mustafa** posedues individual **Spitali Rajonal PRIM.Daut Mustafa P.SH.** me seli ne Prizren rr.”**Bajrije Bahtjari**”,nr.// me të cilën kanë kërkuar leje për **aneks ndertimin –shkallet dhe ashensore te objektit te Klinikes se Pediatrie ne Spitalin e Prizrenit** në bazë të nenit 3 alineja 1 pikat 1.7 , 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alinea 1. Pika 1.1 nenin 15 alinea 1 pika 1.1 , neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 ,si dhe konform nenit 14,15,16,17,18 dhe 19 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 , si dhe konform nenit 25 të Rregullores nr.02/2022 për Taksa Komunale nr. 001/0011-99275 të datës 30 qershor 2022, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe nenit 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022-2030 nr. 001-011-48192 të datës 31.03.2022 merr këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	<u>Spitali Rajonal PRIM.Daut Mustafa P.SH.</u>		
Adresa:	“Bajrije Bahtjari”,nr.//. Prizren		
Telefoni:	/	Emaili:	

Emri i projektit	<u>Aneks ndertimin –shaklet dhe ashensore te objektit te Klinikes se Pediatrie ne Spitalin e Prizrenit</u>		
Emri i projektuesit	“ENG IDEA SH.P.K.		
Adresa:	“ Brigada 123”,pn.-Suhareke		
Telefoni:	//	Emaili:	engidea16@gmail.com

Me këtë Vendim , aplikuesit për leje ndërtimore **Spitali Rajonal PRIM.Daut Mustafa** me seli ne Prizren rr.”**Bajrije Bahtjari**”,nr.// me të cilën kanë kërkuar leje për **aneks ndertimin –shaklet dhe ashensore te objektit te Klinikës së Pediatrie ne Spitalin e Prizrenit** ne Prizren në ngastrën kadastrale **P-71813068-08442-1 sip=96094m² ,O-71813068-08442-0320-0 Z.K.Prizren.**

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	Prizren	
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Prizren Objekti – <u>Aneks ndertimin –shaklet dhe ashensore te objektit te Klinikës së Pediatrie ne Spitalin e Prizrenit</u> me etazhitet P+3 ne ZSH do të ndërtohet në parcelën kadastrale me nr. P-71813068-08442-1 sip=96094m² ,O-71813068-08442-0320-0 Z.K.Prizren sipas kopjes së planit. Sipërfaqe bruto e perdhese është S=94.5m ² . Sipërfaqja bruto e katit I S=94.5m ² Sipërfaqja bruto e katit II S=94.5m ² Sipërfaqja bruto e katit III S=94.5m ² Sipërfaqja bruto e objektit S=378m ² (sipas lejes)	GPS Koordinatat:

- Lirohet nga Taksa Komunale.

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtimi i ri ☒	Rindërtim ☐ Ripatim ☐
Kategoria e ndërtimeve te propozuara:	
Kategoria I ☒	Kategoria II ☐
A përfshin kërkesa ndryshimin e destinimit? Po ☐ Jo ☒	
Përdorimi i propozuar: objektit – <u>Aneks ndertimin –shaklet dhe ashensore te objektit te Klinikës së Pediatrie ne Spitalin e Prizrenit</u>	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Spitali Rajonal PRIM.Daut Mustafa** posedues individual **Spitali Rajonal PRIM.Daut Mustafa P.SH.i** lejohet ndërtimi i **Objektit – Aneks ndertimin –shaklet dhe ashensore te objektit te Klinikës së Pediatrie ne Spitalin e Prizrenit.**
Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore.Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;

- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontratkuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
 - Ndrysimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Spitali Rajonal PRIM.Daut Mustafa posedues individual Spitali Rajonal PRIM.Daut Mustafa P.SH. ka kërkuar nga organi kompetent DUPH lëshimin e lejes ndërmore objektin Aneks ndertimin –shakllet dhe ashensore te objektit te Klinikes se Pediatrie ne Spitalin e Prizrenit.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërmore, andaj u vendos si në dispozitiv.


Kjo Leje Ndërmore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësim të dokumentacionit
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Vërtetimi nga sektori i menagjimit të mbeturinave-Drejtoria e Shërbimeve Publike.
- Pëlqimi nga Kompania Rajonale e Ujitjes- “Radoniqi -Dukagjini”Sh.A.
- Pëlqim nga Agjencioni Menaxhimit Emergjent.
- Kater kopje të projektit kryesor.

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.


DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
Nr.04-351/02-19581

Bashkëpunëtor profesional:



Zana Belloda, inxhi. dip. ark.

DREJTORI:


Florent Ukaj, ecc.dip.